



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:017043

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05630444

**Ac.nr.4330/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.Zh.B., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S., avokat në Gjiilan, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.R., me objekt kontesti pagesa e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.119/2021, të datës 15.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.119/2021, i datës 15.04.2022, në pikën I të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

**II.** Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjyqimit të atakuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.119/2021, të datës 15.04.2022, ka vendosur si në vijim: “ I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.Zh.B. nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura, Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që paditëses F.Zh.B. nga Gjakova, në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj vlerën e tre pagave bazë dhe atë në shumën prej 1,275.00 euro, me kamatën ligjore prej 8%, duke filluar nga 29.01.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumat e gjykuara, dhe atë në emër të kompensimit të tre pagave jubilarë t'ia paguaj shumën prej 341.28€”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore të hedhet poshtë.

Paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohen si i bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 29.01.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për pagesën e shpërblimit jubilar. Në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka parashtruar së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura e sistemuar në punët dhe detyrat e punës Infermiere në Repartin Obstetrik të Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë. Ka shtuar se nga vërtetimi i marrëdhënies së punës vërtetohet fakti se paditësja ka filluar punën tek e paditura që nga data 01.04.1991 e tutje dhe e njëjta i ka 30 vite përvojë punë. Ka theksuar së kërkesa e paditëses është parashtruar konform nenit 17 paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar në shumë prej 1,616.28€, në vlerë të tre pagave mujore me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura në përgjigjen në padi, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se pagesa e shpërblimit jubilar nuk i është bërë në mungesë të mjeteve buxhetore, pasi që Ministria e Financave nuk ka paraparë vijë buxhetore për këtë kategori dhe ndarje buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Më tutje e njëjta e ka kundërshtuar edhe lartësinë e vlerës së kontestit pasi që në të është përfshirë edhe shujta dhe kujdestaria si shtesë në pagë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.119/2021, të datës 15.04.2022, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së nga kontrata e punës e paditëses Nr. 3242 e datës 31.12.2012, e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse vërtetohet fakti se paditësja vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura më detyrat e punës si Infermiere në Repartin Obstetrik. Ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, i datës 22.01.2021, është vërtetuar fakti se paditësja është e punësuar pranë të paditurës që nga data 01.04.1991 e tutje, ku edhe nga lista e pagës së lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, u vërtetua fakti se e njëjta i ka 30 vite të përvojës së punës dhe realizon pagë në lartësi prej 538,76€. Gjykata ka gjetur së në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj), dhe me neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: *“KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”*. Me nenin 17 par. 3 nën 3.3 të KKS parashihet se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tre pagave mujore të tij”*, ndërsa par. 4 i këtij neni parashihet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikë I të dispozitivit të aktgjykimi të atakuar, pasi nga provat e administruara ka gjetur së paditësja tek e paditura i ka 30 vite përvojë punës, dhe rrjedhimisht e njëjta i ka plotësuar kushtet e parapare me nenin 17 par. 3 pika 3.3 të KKS-së, për të qenë përfitues i shpërblimit jubilar në vlerë të tre pagave bazë, mirëpo të njëjtës nuk i është paguar nga ana e të paditurës. Lartësinë e pagesë bazë në shumë prej 425,00 €, gjykata e vërtetoi sipas listës së pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës. Për faktin se paditësja ende vazhdon të punoj te e paditura, rrjedh se si punëdhënësi i fundit për të njëjtën është Spitali i Përgjithshëm “Isa Gerezda”, në Gjakovë.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika I e dispozitivit të aktgjykimit, përkatësisht shumën në lartësi prej 341,28 euro, pasi që ka vlerësuar se paditëses i takojnë tre paga bazë të parapara si në listën e pagave, dhe jo duke përfshirë shtesat që i ka pranuar nga e paditura ( siç janë: shtesat për shujta, kujdestari). Kjo për faktin se shtesat tjera nga paga, duke përfshirë bonuset etj., të punësuarit i takojnë kur ai gjatë angazhimit në detyra të punës arrin të realizoj shtesat në ushqim, punë jashtë orari, shtesat për kujdestari etj.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i ka gjetur të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme, pasi që paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKS, kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të aktgjykimi. Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382.2 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk ka qenë kontestuese fakti së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura më detyrat e punës si Infermiere në Repartin Obstetrik, dhe së e njëjta ka mbi 30 vite përvojë pune, fakt i cili është vërtetuar edhe nga kontrata e punës Nr. 3242 e datës 31.12.2012, dhe vërtetimi i datës 22.01.2021, i lëshuar nga e paditura, ku theksohet së paditësja punon tek e paditura prej datës 01.04.1991, e tutje. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar edhe lartësinë e kërkesës pasi që nga lista e pagave buxheti i Republikës së Kosovës, është vërtetuar së paditësja ka lartësinë e pagës bazë në shumë prej 425.00 euro në muaj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 17 paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, është paraparë së *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij”*. Tutje sipas paragrafit 4 të këtij neni përcaktohet së *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Siç është cekur me sipër në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura ku në bazë të vërtetimit për përvojën e punës të datës 22.01.2021, të lëshuar nga e paditura, është vërtetuar fakti së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 01.04.1991, e që rezulton së 30 vite të përvojës së punës i ka arritur me datë 01.04.2021, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale. Andaj, gjykata e shkallës së parë duke i referuar këtyre dispozitave, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur që paditëses për 30 vite të përvojës së punës t’i njihet kompensimi në vlerë të tre pagave mujore në shumë të përgjithshme prej 1,275.00 euro.

Sa i përket pretendimit ankimor së paditësja nuk e ka plotësuar kushtin e shterimit të mjeteve brenda institucionit në përputhje me nenin 78 të Ligjit të Punës, pasi që nuk ka parashtruar kërkesë me shkrim për realizimin e kërkesës për shpërblim jubilar tek e paditura, në mënyrë që të marrë përgjigje brenda afatit ligjor, duke i dhënë mundësinë institucionit që të trajtoj këtë kërkesë, Gjykata e Apelit, vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditëses t’ia paguaj shpërblimin jubilar në afat prej një muaj pas plotësimit të kushteve siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 17 të KKS-së, dhe së në rastet kur kemi të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuarit, në këtë rast paditësja për realizimin e të drejtës së saj t’i drejtohet gjykatës me padi. Ndërsa lidhur me pretendimin së e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv pasi që me asnjë akt juridik nuk është

përcaktuar që përmbushja e detyrimit për pagesën e shpërblimit jubilar të realizohet nga e paditura, dhe si e tillë kërkesëpadia duhet drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që sipas paragrafit 4 të nenit 17 të KKS-së punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, e që në këtë rast si punëdhënësi është e paditura, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale është nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit me të latë mbikëqyrës në sektorin e shëndetësisë, ku sipas nenit 4 të kësaj kontrate është përcaktuar së kjo kontratë gjënë zbatim për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësor. Lidhur me pretendimin se e paditura si njësi organizative vartëse e SHSKUK-së nuk posedon xhirollogari të pavarur, dhe në bazë të buxhetit të përcaktuar për vitin 2021, nuk është paraparë vij buxhetore për këtë kategori, dhe në mungesë të linjës buxhetore përkatësisht mjeteve financiare e paditura nuk ka mundësi objektive për ta përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilarë, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditëses dhe detyrimin e të paditurës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimit juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadiës nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën refuzuese të kërkesëpadiës.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.4330/2022, datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Hysni Bardheci